



PARAQITJE NË KOMISIONIN E EKONOMISË, FINANCAVE DHE TË PRIVATIZIMIT, 22 DHJETOR 2000.

Të nderuar deputetë,

Kuvendi është organi më i lartë legjislativ i vendit ku Banka e Shqipërisë, në bazë të nenit 2 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", ka detyrimin të raportojë në lidhje me përmbushjen e objektivit kryesor dhe të detyrave të tjera që asaj i janë përcaktuar në këtë ligj. Si Guvernator i Bankës së Shqipërisë jam këtu sot për të paraqitur këtë raport. Por, më lejoni të komunikoj që raportimin në Kuvend, Banka e Shqipërisë e konsideron jo vetëm një detyrim ligjor, por edhe një detyrim moral të saj për të qenë sa më transparente me ju dhe publikun, për të rritur përgjegjshmërinë e saj, për të shpjeguar se pozicioni i institucionit të pavarur nuk i jep asaj të drejtën të shpërdorjë pushtetin.

1. ZHVILLIMET NË ÇMIMET E KONSUMIT.

Po fillojmë raportimin me ecurinë në çmimet e konsumit pasi dhe objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Me fjalë të tjera, për vitin 2000 objektivi është arritja e një norme vjetore inflacioni në nivelin 2 - 4 për qind.

Prej tre vitesh po vërehen norma të ulëta inflacioni dhe mund të themi se është arritur stabiliteti i çmimeve. Banka e Shqipërisë deklaron se, në vazhdimësi të dy viteve të mëparshme, edhe në fund të vitit 2000 do të sigurohet një normë vjetore e ulët pozitive e inflacionit. Periudha e normave negative të inflacionit, e vërtetuar qysh në maj të vitit 1999, duket se ka përfunduar.

Në fund të muajit nëntor indeksi i çmimeve të konsumit arriti në nivelin 220,19 që do të thotë 0,4 për qind më i ulët se fundi i muajit dhjetor 1999. Këto të dhëna tregojnë se, ndërsa nuk ka më dyshim për tejkalimin e kufirit të sipërm të objektivit, mbetet ende e diskutueshme arritja e nivelit të poshtëm.

Pra, bazuar në të dhënat e njëmbëdhjetëmujorit të këtij viti si dhe në sjelljen disavjeçare të çmimeve në muajin dhjetor, gjykojmë që inflacioni i këtij viti do të rezultojë pranë nivelit 2 për qind. Në analizimin e faktorëve që shpjegojnë ecurinë e çmimeve të konsumit Banka e Shqipërisë ka vështirësi, që vijnë si pasojë e historisë së shkurtër (rreth 9 vjet nga të cilat 2-3 vjet nuk duhet të merren në konsideratë për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme që i kanë shoqëruar) e varfërisë së statistikave ku spikat mungesa e llogarive kombëtare apo edhe nga shkaqe të tjera. Pavarësisht nga këto mangësi është arritur të perceptohet një pjesë e faktorëve, që kanë ndikim të konsiderueshëm në këtë tregues.

Si faktorët më kryesorë përmendim përpjekjet serioze të Bankës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Financave. E para nëpërmjet vendosjes dhe mbajtjes nën kontroll të ofertës së parasë dhe e dyta nëpërmjet konsolidimit fiskal. Të dyja politikat e ndjekura, ajo monetare dhe fiskale, janë pranuar se kanë qenë të besueshme dhe rezultat i tyre ka qenë dhe një shkallë e kënaqshme e stabilitetit makroekonomik. Duhet pranuar se një rol të caktuar ka pasur dhe veprimi i faktorëve rastësorë. Në vijim, në mënyrë më të detajuar, pasqyrohen disa nga faktorët të cilët vlerësohen të kenë qenë kyç në përcaktimin e ecurisë së inflacionit gjatë vitit 2000.

- * Përbushja e objektivave sasiorë, të vendosur në programin monetar, nga ana e Bankës së Shqipërisë është arritur në mënyrë të kënaqshme gjatë gjithë vitit 2000. Sipas pritshmërisë, për fundin e vitit 2000, të dhënat faktike do të jenë brenda kufijve sasiorë të vendosur për rezervat valutore neto, për mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë dhe për mjetet e brendshme neto të të gjithë sistemit bankar.
- * Zhvillimet fiskale gjatë vitit 2000 janë mbajtur vazhdimisht nën kontroll. Pjesa e deficitit buxhetor, që do të financohet me burime të brendshme pritet të jetë nën nivelin e programuar, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në mbajtjen nën kontroll të inflacionit. Po kështu, qëndrueshmëria fiskale, duke mos rritur barrën tatimore, nuk ka dhënë arsye për një rritje të çmimeve.
- * Gjatë gjithë vitit 2000, çmimi në dollarë amerikanë i monedhës shqiptare ka ndjekur ecurinë e monedhës amerikane në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që ka qenë stabël dhe shpeshherë ka fituar terren ndaj monedhave europiane. Këto dhe të tjera zhvillime, kanë rritur besimin e Bankës së Shqipërisë se monedha europiane,



euro, gjithnjë e më shumë po bëhet e rëndësishme për ecurinë e inflacionit në Shqipëri. Kjo vjen si pasojë e faktit që rreth 80 për qind e transaksioneve në llogarinë korente kryhen me vende të Bashkimit Europian dhe, nga ana tjetër, vlera e transaksioneve kapitale vazhdon të jetë shumë më e ulët krahasimisht me atë të llogarisë korente.

- * Norma e inflacionit të importuar, për shkak të nivelit të ulët të tij në vendet partnere tregtare, ka qenë një tjetër faktor ndikues. Nga ana tjetër, ecuria më e mirë e sektorit të bujqësisë në plotësimin e nevojave të tregut të brendshëm dhe rritja e ofertës së produkteve bujqësore ka dhënë një kontribut në këtë drejtim.
- * Megjithëse nuk mund të flasim me saktësi, ne vlerësojmë se gjatë vitit në vazhdim nuk është evidentuar ndonjë zhvillim i rëndësishëm që të ndikojë në çmimet e prodhimit (qoftë në kostot e punës apo të faktorëve të tjerë të prodhimit). Megjithëse konjuktura ndërkombëtare diktoi një rritje të çmimeve të produkteve energjitike, shkalla e shfrytëzimit të burimit nga industria vendase është modeste dhe ndikimi i saj nuk është aq i ndjeshëm.

Vlerësohet që për vitin e ardhshëm, do të vazhdojmë të përballemi me presione inflacioniste duke u bazuar në:

- * ecurinë e çmimeve të konsumit për tre vitet e fundit, por duke u përqendruar më tepër në vitet 1999-2000;
- * supozimin që në fund të vitit 2000 norma vjetore e inflacionit do të jetë rreth 2 për qind;
- * supozimin që viti 2001 do të shënojë kthesë në ecurinë e vlerës së euros me drejtim mbiçmimin e saj;
- * krizën energjitike që përfshiu vendin si në rritje të çmimeve të karburanteve ashtu edhe në kufizimet me furnizim të energjisë elektrike;
- * transmetimin e vonuar të vendimeve në vazhdim të politikës monetare, të cilat kanë synuar zbutjen nëpërmjet reduktimit të normës së interesave;
- * rritjen e pritshme të investimeve kapitale në masën 23.3 për qind;
- * parashikimin për deficitin buxhetor dhe financimin e tij;
- * deklarimin për rritje pagash dhe mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme elektorale, situata të cilat, përveç efekteve psikologjike, potencialisht krijojnë shmangie ose më e pakta vështirësojnë administrimin e problemeve.

Tabela 1: Seritë vjetore të normës së inflacionit (në %).

Muajt	1998	1999	2000
Janar	37.3	6.0	-1.3
Shkurt	22.6	3.5	-1.3
Mars	24.0	2.0	-2.1
Prill	28.0	0.4	-1.4
Maj	26.4	-0.1	-0.1
Qershor	17.8	-0.6	0.1
Korrik	16.9	0.1	-1.3
Gusht	16.7	-0.6	-0.7
Shtator	16.5	-1.9	0.9
Tetor	11.2	-1.8	1.7
Nëntor	8.9	-1.2	1.8
Dhjetor	8.7	-1.0	

Më konkretisht dua të ndalem në krizën energjitike. Me shportën aktuale pesha e karburanteve dhe e energjisë elektrike nuk është e konsiderueshme dhe rritja në çmimin e energjisë nuk konvertohet drejtpërdrejt në rritje të inflacionit. Por, duhet të kemi parasysh efektin zinxhir që jep rritja e çmimit të energjisë në rritjen e kostos së transportit apo të prodhimit gjë që në një kohë të mëvonshme konvertohet në produkte, që në treg dalin me çmime më të larta. Prandaj, kriza që filloi në muajin tetor efektet e saj i jep me disa muaj vonesë. Se sa do të jetë realisht ndikimi kjo ende nuk është e mundur të përcaktohet pasi: së pari, ende nuk është matur ndikimi i deritanishëm i kësaj krize, së dyti, nuk është e qartë se për sa kohë do të zgjasë kriza dhe a do të ketë përkeqësim apo përmirësim.

Pavarësisht nga sa më sipër, për vitin 2001 objektivi për inflacionin nuk do të ndryshojë në krahasim me vitin 2000, duke u përcaktuar si një interval në masën 2-4 për qind. Por, gjykohet që norma faktike të jetë mbi atë të vitit 2000.

2. ZHVILLIMET NË POLITIKËN MONETARE.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë për vitin 2000 duhet konsideruar si vazhdimësi e politikës së vitit 1999. Ajo ka vazhduar të orientohet në kahun zbutës, duke reflektuar ndjekjen nga afër të zhvillimeve kryesisht në çmimet e konsumit, por edhe të ecurisë së vlerës së monedhës shqiptare, të ecurisë së depozitave apo të faktorëve psikologjikë. Politika monetare në këtë periudhë u karakterizua nga zëvendësimi gradual i instrumenteve direkte me ato indirekte, të cilat pasqyrojnë më mirë forcat e tregut.



Kjo u arrit nëpërmjet respektimit të të tre objektivave monetarë sasiore të vendosur, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në menaxhimin e kërkesës së brendshme në ekonomi. Sistemi bankar ka ardhur duke e rritur financimin e ekonomisë nëpërmjet dhënies së më shumë kredive.

Ndër objektivat afatmesëm të Bankës së Shqipërisë është adoptimi i regjimit të përcaktimit të objektivit për inflacionin (*inflation targeting*).

2.1. Instrumentet e përdorura për zbatimin e politikës monetare.

Banka e Shqipërisë ka si objektiv operacional kontrollin mbi ofertën e parasë dhe instrument bazë ka qenë përqindja e interesit. Ky instrument deri në pjesën e parë të vitit 2000, ka qenë identifikuar me përqindjen minimale të vendosur për normat e depozitave me afat në lekë në bankat shtetërore. Në pjesën e dytë të vitit ky instrument u zëvendësua me instrumentet indirekte, të cilat Banka e Shqipërisë ka në dispozicion si: ankandet e marrëveshjeve të riblerjeve, rezervën e detyrueshme, kredinë e rifinancimit dhe kredinë lombard. Por, rolin më kryesor e ka luajtur norma e interesit të përcaktuar në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes.

Heqja dorë nga instrumentet direkte u bë e nevojshme pasi efektiviteti i tyre dhe mekanizmi i transmetimit të vendimeve në ekonomi kanë qenë të një shkalle të ulët. Kjo gjë ndikonte në një shpërndarje joefektive të burimeve financiare bazuar në mekanizmin e çmimit.

Gjithashtu, nuk nxiste ndërmjetësimin bankar dhe frenonte konkurrencën në treg. Këto instrumente janë të domosdoshme për zbatimin e politikës monetare në kushtet e mungesës së kuadrit institucional dhe kur tregu i parasë është ende i brishtë.

Për Bankën e Shqipërisë, gjashtëmujori i parë i vitit 2000, konsiderohet si fundi i periudhës tranzitore për kalimin përfundimtar në instrumentet indirekte të politikës monetare për arritjen e objektivave të saj të ndërmjetëm dhe operacionalë.

Kështu u përcaktua si objektiv operacional norma e interesit për bonot e thesarit tremujore si dhe niveli i rezervave të tepërta në sistem dhe si instrument në dispozicion ankandet javore të repove. Nëpërmjet këtyre objektivave operacionalë, Banka e Shqipërisë synon të ndikojë në normat e interesit të tregut të parasë.

Zbatimi i politikës monetare vetëm në instrumentet indirekte u mundësua nga puna e vazhdueshme e Bankës së Shqipërisë, situata e stabilizuar makroekonomike dhe fiskale, përmirësimi i nivelit të mbikëqyrjes bankare sipas standardeve ndërkombëtare, përfundimi i privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, duke sjellë edhe ndryshime të rëndësishme në pjesët e tregut midis bankave sipas kapitalit; përgatitja e procedurave për privatizimin e Bankës së Kursimeve brenda vitit 2001 si dhe përvojat e mëparshme të përdorimit të instrumenteve afatshkurtra në lëvizjet e tregut etj..

Aktualisht, përdorimi i ankandeve javore të repove, i ofron Bankës së Shqipërisë një hapësirë të gjerë për të ndërhyrë në treg, rritje të fleksibilitetit të kalimit të fondeve në sistem, duke i dhënë mundësi të reagojë shpejt dhe me eficiencë ndaj luhatjeve të likuiditetit nëpërmjet përcaktimit të tipit të ankandit dhe rritjes në një nivel më të lartë të transparencës për gjithë tregun.

Për vitin 2000, niveli i rezervës së detyrueshme në lekë dhe në valutë mbeti i pandryshuar, në nivelin 10 për qind të detyrimeve të bankave të nivelit të dytë ndaj klientëve.

Gjatë gjashtëmuajorit të dytë të këtij viti u ndërmorën hapa në drejtim të përmirësimit të instrumentit të rezervës së detyrueshme. Në funksion të shpërndarjes më të drejtë të të ardhurave mes bankave tregtare, Bankës së Shqipërisë dhe buxhetit të shtetit u realizua remunerimi i rezervës së detyrueshme. Kjo pritet të ndikojë në uljen e kostos direkte të ndërmjetësimit të çdo banke në veçanti dhe të sistemit në tërësi.

Kredia lombard dhe ajo e rifinancimit, si kreditë më të shtrenja, që ofrohen nga Banka e Shqipërisë, edhe gjatë vitit 2000 nuk janë përdorur asnjëherë. Kjo, ndoshta, është pasojë e stabilizimit të treguesve makroekonomikë dhe financiarë, por sidomos e krijimit të rezervave të tepërta të mjaftueshme për bankat për realizimin e veprimtarisë së tyre.

Gjithashtu, po punohet për përmirësimin e mëtejshëm, në një kohë të afërt, të të gjithë kuadrit rregullator të instrumenteve indirekte të Bankës së Shqipërisë, në funksion të rritjes së eficiencës dhe të fleksibilitetit të tyre.

Mbështetja në këto instrumente bëhet me synim që të rrisë fleksibilitetin në hartimin dhe në zbatimin e politikës monetare, si dhe të ndihmojë në zgjerimin dhe zhvillimin e tregjeve, të ndikojë në përmirësimin e



eficiencës së ndërmjetësimit të sektorit financiar, të përmirësojë efektivitetin e investimeve si dhe të nxisë rritjen e kursimeve duke i kanalizuar ato në sistemin bankar.

2.2. Ecuria e normave të interesit.

Politika e Bankës së Shqipërisë në lidhje me normat e interesit ka qenë reduktimi i vazhdueshëm i tyre. Zbatimi i saj, megjithëse mund të mos ketë siguruar efektet maksimale të pritshme, përsëri ka ndikuar ndjeshëm në ecurinë e normave të interesit në ekonomi në kahun e dëshiruar.

Rezultat i politikës së ndjekur nga Banka e Shqipërisë, megjithëse tregu është i brishtë dhe mekanizmi i transmisionit është joeficient, ka qenë ulja e interesave për depozitat me afat gjë, e cila ka ndikuar në sjelljen e *yield*-it të bonove të thesarit.

Diferencat midis normave përkatëse të interesit për të njëjtat maturime kanë ardhur duke u zbutur, sidomos ato për periudha të shkurtra maturimi. Në pamje të parë duket sikur reduktimi i normave të interesit nuk është ndjekur nga norma e kredihënies, për periudhën tremujore. Në realitet, efekti “fshihet” pas strukturës së kreditimit në Shqipëri. Bankat tregtare janë të angazhuara në kredihënien në valutë. Megjithatë, periudha dhjetor 1999-tetor 2000 paraqet një tendencë të lehtë në drejtim të reduktimit të normave të interesit edhe për huadhënien për maturitete gjashtë dhe dymbëdhjetëmujore.

Tabela 2: Normat mesatare vjetore të interesit në lekë (në %).

Treguesi	Dhjetor 1999	Tetor 2000
1. Depozitat	9.14	8.1
2. Bonot e thesarit	15.79	12.44
3. Huadhënia	26.8	25.89

Tabela 3: Normat mesatare gjashtëmujore të interesit në lekë (në %).

Treguesi	Dhjetor 1999	Tetor 2000
1. Depozitat	9.97	7.9
2. Bonot e thesarit	15.48	11.28
3. Huadhënia	25.80	19.27

Tabela 4: Normat mesatare tremujore të interesit në lekë (në %).

Treguesi	Dhjetor 1999	Tetor 2000
1. Depozitat	9.51	7.21
2. Bonot e thesarit	14.77	7.85
3. Huadhënia	21.70	26.56

2.3. Kreditimi i ekonomisë.

Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 2000, inicioi një fushatë në mbështetje të kreditimit të ekonomisë nga sistemi bankar. Kjo fushatë u konceptua si bashkëbisedime, që zgjeruan rrethin e tyre nga bankat në përfaqësues të biznesit, të medias dhe të ftuar nga organet legjislativë dhe ekzekutive. Diskutimet, veç arritjeve, prezantuan kërkesa për problemet ligjore, për fusha strategjike që duhet të sugjerohen për mbështetje etj.. Banka e Shqipërisë ftoi bankat që të jenë më transparente në aktivitetet e tyre, duke theksuar synimet e veta për rritjen e transparencës, ofroi mundësitë e publikimeve dhe në faqen e saj të internetit.

Kreditimi i ekonomisë për periudhën janar - tetor 2000, në terma relativë, është rritur ndjeshëm krahasuar me vitin e kaluar. Ndërkohë që, gjatë gjithë vitit 1999, u akordua kredi e re në masën 8 miliardë lekë, vetëm për dhjetë muajt e parë të vitit 2000 niveli i akordimit të kredive të reja ka arritur në masën 19 miliardë lekë. Megjithë këtë rritje, duhet pranuar se në terma absolutë kredia për ekonominë vazhdon të jetë akoma e ulët dhe për më tepër vazhdon të kreditohet vetëm në valutë. Gjatë periudhës dhjetor 1999 - tetor 2000, teprica e kredisë për ekonominë është rritur me 5,9 miliardë lekë, nga e cila 5,6 në valutë dhe 0,3 në lekë.

Përsa i përket afateve të lëvrimit, kredia afatshkurtër dhe ajo afatmesme janë rritur respektivisht me 3 dhe 2,6 miliardë lekë, ndërsa kredia afatgjatë me 0,3 miliardë lekë. Duke iu referuar shifrës 19 miliardë lekë (kredi e re), që nga fillimi i vitit situata është:

- 15,8 miliardë lekë kredi në valutë;
- 9,8 miliardë lekë janë kredi afatshkurtër.

Kreditë janë akorduar thuajse tërësisht për sektorin privat të ekonomisë dhe për individët. Siç është theksuar vazhdimisht, pjesa më e madhe e kredive janë dhënë në valutë. Ka disa arsye për një sjellje të tillë, të cilat po i rendisim më poshtë:

- Në aktivitetin kreditues janë të angazhuara bankat private, të cilat i kanë pasivet e tyre kryesisht në valutë. Për to është më e përshtatshme që edhe aktivet, konkretisht kreditë, t'i krijojnë po në valutë për të shmangur rrezikun e kursit të këmbimit.
- Struktura e kredisë sipas aktivitetit ekonomik është e tillë që vetë bizneset preferojnë marrjen e kredive në valutë. Në muajin tetor vërehet që peshat e kredive dhënë për ndërtim dhe tregti, në totalin

e kredive janë përkatësisht 26.5 dhe 26.6 për qind. Në të dyja këto aktivitete pagesat bëhen me valutë, sepse dhe ligji në fuqi i quan të vlefshme pagesat në valutë edhe për transaksionet brenda vendit. Për këtë arsye preferohet kredia në valutë.

- Normat e interesit që aplikohen për kredinë në valutë janë më të ulëta dhe në kushtet e qëndrueshmërisë ekonomike, bizneset prirën drejt marrjes së huave në monedha të forta.
- Ritmi i pranimit të depozitave në valutë në sistemin bankar është i lartë duke krijuar likuiditet në monedha të huaja.

Mund të ketë dhe arsye të tjera që shpjegojnë një qëndrim të tillë, por Banka e Shqipërisë beson se këto janë arsyet më kryesore. Ajo ç'ka kemi bërë ne është një paralajmërim i vazhdueshëm për rrezikun që mund të shkaktohet nga krijimi i detyrimeve në valutë si për bizneset ashtu edhe për bankat për arsye se, aktiviteti ekonomik, në përgjithësi, në Shqipëri kryhet në monedhën e vendit. Kjo mund të krijojë rrezik në një përmbysje situatë (nënçmim të monedhës së vendit) dhe do të ulë shkallën e kthimit të kredive duke rritur nivelin e huave me probleme në banka, apo duke rritur barrën për bizneset. Megjithatë, duhet të kihet parasysh që bankat tregtare në veprimtarinë e tyre janë të pavarura.

Tabela 5: Ecuria e treguesve të kreditit (në miliardë lekë).

Treguesi	Dhjetor 1999	Viti 2000			
		Trem. I	Trem. II	Trem. III	Tetor
Teprica gjithsej e kredisë e sistemit bankar ²⁰ .	19.9	21.4	22.7	25.2	25.8
Teprica e kredisë e sistemit bankar për sektorin publik.	1.7	1.6	1.6	1.6	1.6
Teprica e kredisë e sistemit bankar për sektorin privat.	18.2	19.8	21.1	23.5	24.2
Nga kjo: në lekë,	10.6	10.6	10.6	10.6	9.6
në valutë.	9.3	10.8	12.1	14.5	14.6
Pesha (në %) e kredisë në valutë.	48.0	52.0	55.0	57.0	57.0
Kredia e re e sistemit bankar.	8.0	3.4	6.9	6.8	1.8
Kredia e re në lekë e sistemit bankar.		0.6	1.1	1.0	0.4
Kredia e re në valutë e sistemit bankar.		2.8	5.9	5.8	1.3
Pesha (në %) e kredisë në valutë.		82.0	85.5	85.5	75.0

Bankat më aktive në tregun e huadhënies, janë Banka Italo -Shqiptare, Banka Tirana, Banka Fefad, Banka Amerikane dhe Banka Alfa Kredit.

Nga të dhënat e raportuara për bizneset që janë kredituar nëpërmjet sistemit bankar, 26.5 për qind të kredive e kanë marrë aktivitetet e ndërtimit, rreth 27 për qind tregtia, rreth 16 për qind industria përpunuese,

5 për qind hotelet dhe restorantet, 5 për qind pasuritë e patundshme dhe pjesën tjetër bujqësia, peshkimi, transporti, shërbimet etj..

Mesatarisht, ekonomia është kredituar me 0.6 miliardë lekë çdo muaj. Për periudhën nëntor - dhjetor 2000 mbetet që ekonomia të kreditohet edhe me 1.6 miliardë lekë të tjera. Po të ruhet niveli mesatar mujor i kreditimit në tremujorin e tretë të vitit 2000 (0,8 miliardë lekë), vlerësohet të arrihet parashikimi në programin monetar për kreditimin e ekonomisë në fund të vitit 2000 (7,5 miliardë lekë). Këtë e mbështesim në praktikën e viteve të kaluara që në tremujorin e tretë dhe të katërt bankat akordojnë më shumë kredi.

2.4. Programi monetar i Bankës së Shqipërisë për vitin 2001.

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 14 nëntor, mori në shqyrtim dhe miratoi programin monetar për vitin 2001. Programi monetar është hartuar në kuadrin e programit afatmesëm (Reduktimi i Varfërisë dhe Rritja) të rënë dakort me FMN-në. Ai është pjesë përbërëse e një pakete më të gjerë masash makroekonomike e financiare.

Programi monetar reflekton parashikimet për zhvillimet më të rëndësishme makroekonomike si dhe angazhimin e Bankës së Shqipërisë për përmbushjen e objektivit kryesor të saj, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Banka e Shqipërisë, në të gjitha aspektet e veprimtarisë së saj, ka në themel bindjen se kontributi më i çmuar i saj për një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe një nivel të ulët papunësie është ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Ky angazhim i Bankës së Shqipërisë përbën edhe fokusin e programit monetar të saj; ai lidh parashikimet për zhvillimet më të rëndësishme makroekonomike me masat, që parashikon të ndërmarrë Banka e Shqipërisë në fushën monetare gjatë vitit në vazhdim.

Zhvillimet pozitive makroekonomike për vitin 2000 mund të sintetizohen në dy tregues: 1) rritja ekonomike vlerësohet të jetë 7.8 për qind, diçka më e lartë se ajo e parashikuar në fillim të vitit, dhe 2) inflacioni, i matur nga indeksi i çmimeve të konsumit, parashikohet të jetë rreth nivelit 2 për qind.

Mbështetur në zhvillimet e vitit 2000, të përshkruara më sipër, programi monetar për vitin 2001 bazohet në supozimin për një rritje ekonomike prej 7.3 për qind në kushtet e mbajtjes së inflacionit në nivele të përafërta



me vitin 2000.

Programi monetar është harmonizuar edhe me zhvillimet më të fundit në fushën fiskale dhe me projektbuxhetin e qeverisë për vitin 2001. Financimi i brendshëm i deficitit buxhetor, në përputhje edhe me projektbuxhetin e paraqitur nga Ministria e Financave për vitin 2001, është parashikuar të jetë 15.5 miliardë lekë ose 2.67 e PBB-së.

Ky nivel financimi paraqet një ulje të ndjeshme prej 35 për qind në krahasim me parashikimin e një viti më parë dhe pasqyron thellimin e përmirësimit të administrimit fiskal dhe politikave të reja fiskale të parashikuara nga Ministria e Financave. Ulja e nivelit të financimit të deficitit buxhetor nga ana e sistemit bankar do të krijojë hapësira më të mëdha për rritjen e financimit të ekonomisë.

Kontributi i Bankës së Shqipërisë për financimin e këtij deficiti është parashikuar të jetë 8.7 miliardë lekë. Ky nivel financimi i korrespondon kufirit maksimal të vendosur nga ligji "Për Bankën e Shqipërisë" prej 8 për qind të mesatares së të ardhurave buxhetore të qeverisë gjatë tre viteve të fundit. Një nivel i tillë financimi nga Banka e Shqipërisë nuk gjykohet se do ta shmangë atë nga objektivi i saj kryesor, ruajtja e stabilitetit të çmimeve.

Banka e Shqipërisë ka programuar një rritje të kreditimit për sektorin privat prej 8.1 miliardë lekësh gjatë vitit 2001. Sipas parashikimeve tona, kjo rritje e kredisë për ekonominë do të vijë kryesisht nga rritja e kredisë në valutë. Kjo është një prirje e vrojtuar edhe gjatë vitit 2000 dhe që mendohet se do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2001. Në formimin e këtij opinioni janë mbajtur parasysh disa argumente:

- ritmi i rritjes së depozitave në valutë parashikohet të jetë më i madh se ai i depozitave në lekë gjatë vitit 2001, bazuar në faktin se niveli i normave të interesit për depozitat në lekë ka qenë në ulje të vazhdueshme, ndërsa ai i depozitave në valutë ka qenë relativisht konstant (me një tendencë të lehtë në rritje);
- nivelin më të madh të depozitave në lekë, afërsisht 85 për qind të gjendjes së tyre deri në muajin tetor 2000 e ka Banka e Kursimeve, e cila e ka të ndaluar dhënien e kredive.

Në program është parashikuar një rritje e rezervave valutore bruto të Bankës së Shqipërisë prej 70 milionë dollarësh amerikanë duke arritur në 620 milionë dollarë amerikanë. Kjo mendohet të rrisë mjetet valutore

neto të Bankës së Shqipërisë me 11.3 miliardë lekë. Gjithashtu, niveli i rezervave ndërkombëtare bruto, gjatë vitit 2001, pritet të jetë i mjaftueshëm për përbalimin e 4.6 muajve import të mallrave dhe shërbimeve.

Në përputhje me këto zhvillime dhe duke patur parasysh përmbushjen e objektivit primar të saj, Banka e Shqipërisë procedon me një rritje të kontrolluar të ofertës monetare me synimin për të përmbushur nevojat e rritjes ekonomike për mjete financiare dhe njëkohësisht të mos përcjellë në ekonomi presione inflacioniste. Gjatë vitit 2001 oferta monetare parashikohet të rritet 11.2 për qind ose 36.9 miliardë lekë.

Në program kjo rritje zërthehet sipas komponentëve të saj: në rritje të komponentit "Para jashtë bankave", rritje të depozitave në lekë dhe rritje të depozitave në valutë.

Rritja e parasë jashtë bankave do të jetë e njëjtë me rritjen e ofertës monetare, 11.2 për qind ose 10.7 miliardë lekë. Ky ritëm i njëjtë rritjeje reflekton faktin se, duke iu referuar fundit të vitit 2000, në program nuk është parashikuar ndryshim i raportit të parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare totale gjatë vitit 2001.

Rritja e depozitave në lekë do të përbëjë pjesën më të madhe të rritjes së ofertës monetare, por ritmi i rritjes së saj do të jetë më i vogël. Depozitat në lekë parashikohen të rriten me 9.7 për qind ose 16.4 miliardë lekë. Ky ritëm më i ulët rritjeje në raport me ofertën monetare pasqyron një rishpërndarje të portofolit të aktiveve financiare të publikut si pasojë e uljes së normave të interesit për depozitat në lekë. Pjesa tjetër e rritjes së ofertës monetare do të vijë në formën e rritjes së depozitave në valutë, të cilat parashikohen të rriten me 15.1 për qind ose 9.8 miliardë lekë.

Banka e Shqipërisë ndjek në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programit monetar dhe përputhjen e tij me zhvillimet reale. Në përshtatje me zhvillimet kryesore të vrojtuar, Banka e Shqipërisë qëndron e angazhuar që, në fund të çdo tremujori, ta rishikojë dhe ta përshtasë këtë program në mënyrë që ai të reflektojë sa më saktë dukuritë më të fundit makroekonomike dhe financiare të vrojtuar në vend si dhe masat e marra nga Banka e Shqipërisë për realizimin e objektivave të saj.



3. ZHVILLIMET VALUTORE.

3.1. Kursi i këmbimit.

Si shenjë e integritimit të zhvillimeve në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore me atë ndërkombëtar, kursi i këmbimit të Lekut, përveç ndryshimeve në kërkesën dhe ofertën e brendshme për valutë, ka pasqyruar gjerësisht edhe zhvillimet në tregjet ndërkombëtare të këmbimit.

Kundrejt euros, leku është mbiçmuar. Vlera nominale e raportit euro/leku është çelur në fillim të vitit në nivelin 137.3 (Dem/Lek=70.2) dhe është mbyllur në fund të muajit nëntor në nivelin 128.7 (Dem/Lek=65.8). I shprehur në terma relativë, mbiçmimi i lekut ishte 6.7 për qind. Siç mund të kuptohet, në të njëjtën masë leku është mbiçmuar ndaj të gjithë nënfishave të tjerë të euros. Kundrejt drahmisë greke (GRD), e cila me anëtarësimin e Greqisë në Bashkimin Monetar Europian duke filluar nga data 1 janar 2001, shndërrohet në një nënfish të euros, leku është mbiçmuar në masën 8.2 për qind.

Kundrejt usd, leku është nënçmuar. Në fillim të vitit raporti usd/leku ishte në nivelin 135.2, ndërsa në fund të muajit nëntor, ky raport ishte 149.5. Në terma relativë, leku është nënçmuar në këmbimin me usd në masën 10.6 për qind. Mbiçmimi i lekut ndaj euros dhe nënçmimi i njëkohshëm ndaj usd, ka reflektuar ecurinë e këtyre dy monedhave në tregjet ndërkombëtare të këmbimit, gjatë vitit 2000. Deri në fund të muajit nëntor, vlerësohet që monedha europiane të ketë humbur rreth 19.5 për qind të vlerës së saj në këmbimin me usd.

Lëvizjet në kursin e këmbimit të Lekut gjatë vitit 2000, kanë qenë graduale dhe të balancuara. Për të siguruar një gjë të tillë, Banka e Shqipërisë ka vepruar në treg, veçanërisht në periudhën e tremujorit të tretë, kur ndikimet sezonale me efekte mbiçmuese në kursin e këmbimit të lekut, janë të pritshme. Vetëm në tremujorin e tretë, janë blerë nga sistemi bankar, rreth 17.46 milionë dollarë, ndërkohë që në total, kjo shifër është 35.58 milionë dollarë.

Për vitin e ardhshëm, pritet që kursi i këmbimit të lekut të vazhdojë të jetë i qëndrueshëm, me lëvizje të balancuara që do të absorbohen lehtë nga ekonomia. Banka e Shqipërisë do të jetë e gatshme që të sigurojë këtë ecuri.

3.2. Rezerva valutore.

Deri në datën 5 dhjetor, vlera e rezervës valutore bruto ka arritur në 571.13 milionë dollarë, ndërsa vlera e rezervës valutore neto në 433.16 milionë dollarë. Që nga fillimi i vitit, rritja e vlerës së rezervës valutore bruto kap shifrën 89.54 milionë ose 18.54 për qind.

Deri në këtë datë, hyrjet më të mëdha në rezervën valutore kanë qenë të ardhurat nga investimi i saj në masën 21.95 milionë dollarë si dhe blerje nga bankat tregtare, Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe institucione financiare ndërkombëtare, në masën 94.57 milionë dollarë.

Ndër faktorët reduktues të kësaj periudhe përmendim, pagesat për interesin e borxhit të jashtëm të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe detyrimeve të Bankës së Shqipërisë në masën 12.73 milionë dollarë, dhe shitjet në masën 16.88 milionë dollarë.

Përsa i takon mënyrës së administrimit të rezervës valutore, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka miratuar me vendimin nr. 70, datë 02.08.2000 "Politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore", dokument, i cili përcakton objektivat që ka procesi i investimit të rezervës, limitet për investim sipas monedhave dhe instrumenteve të veçanta etj..

Dokumenti i ri, parashikon shtimin e instrumenteve të investimit të rezervës valutore, duke ruajtur cilësi të larta të sigurisë dhe të likuiditetit. Për t'i paraprirë nevojës për njohje më të mirë të rreziqeve, dokumenti i ri parashikon krijimin e komitetit të investimit dhe të sektorit të vlerësimit të rreziqeve. I pari, do të rrisë aftësinë analizuese dhe vendimmarrëse, brenda treguesve bazë të përcaktuar në dokument nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. I dyti, do të jetë një formë e organizimit brenda departamentit përgjegjës për administrimin e rezervës valutore, e specializuar për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve financiare, si ai i tregut, i kreditit, operacional etj..

4. ZHVILLIMET NË SISTEMIN BANKAR

4.1. Ecuria e sistemit bankar.

Gjatë vitit 2000 në sistemin bankar ka patur disa zhvillime:

- * Zgjerimi i shtrirjes gjeografike të sistemit bankar.
- * Rritja e kapitalizimit të sistemit bankar.



* Rezultat financiar pozitiv.

Në vitin 2000 nuk u dha asnjë licencë për bankë të re, por bankat ekzistuese, në përgjithësi, kanë rritur aktivitetin e tyre. Ato, gjithashtu, janë bërë më të pranishme në qytete të tjera të vendit si në Durrës, Fier, Elbasan, Gjirokastrë dhe Korçë.

Ndërsa në total aktiviteti i sistemit bankar është rritur me 3.2 për qind kundrejt vitit 1999 si pasojë e zgjerimit të ndjeshëm të aktivitetit në grupin e bankave private dhe të përbashkëta me përkatësisht 45.6 dhe 6.5 për qind. Ky fakt konsiderohet pozitiv nga pikëpamja e Bankës së Shqipërisë pasi gjithmonë e më tepër po reduktohet dominimi i bankave shtetërore në tregun bankar për t'i hapur rrugën konkurrencës. Kjo mendohet se do të ndikojë në zhvillimin e këtij tregu, uljen e kostos së ndërmjetësimit financiar dhe sidomos në uljen e kostos për klientët.

Struktura e aktivitetit bankar, në tërësi, nuk ka ndryshuar duke lënë si fusha kryesore aktiviteti, investimet në bonot e thesarit apo në formën e llogarive rrjedhëse e depozitave me afat pranë bankave jorezidente si edhe në aktivitetin kredidhënës dhe grupe kryesore për burimet janë llogaritë dhe depozitat e klientëve. Megjithatë, vlen të theksohet që shtimi i investimeve dhe i burimeve ka qenë i ndryshëm, por dominon rritja e investimeve në letrat me vlerë dhe llogaritë dhe depozitat ndërbankare.

Tabela 6: Struktura e zërave kryesorë të bilancit, më 30.09.2000.
(në % ndaj totalit të bilancit).

Zërat	Pesha
Aktivitet	
Bono thesari	46.4
Llogaritë dhe depozitat ndërbankare	31.1
Teprica e kredisë gjithsej	11.9
Investimet në letrat me vlerë	1.8
Pasivitet	
Llogaritë dhe depozitat e klientëve	84.7
Llogaritë dhe depozitat ndërbankare	2.6
Burimet e përhershme	6.0
<i>Nga këto: Kapitali aksioner</i>	5.6

Kjo strukturë bilanci dikton edhe strukturën e të ardhurave dhe shpenzimeve për sistemin bankar. Të ardhurat dhe shpenzimet kryesore renditen të ardhurat dhe shpenzimet prej interesave, përkatësisht në masën 85.6 për qind të të ardhurave gjithsej dhe 64.4 për qind të shpenzimeve gjithsej. Në fund të shtatorit të vitit 2000, fitimi i gjithë sistemit bankar rezulton të jetë 2.7 miliardë lekë kundrejt 1.3 miliardë lekëve, në fund të vitit 1999. Në përgjithësi, të gjitha bankat e mbyllën rezultatin financiar me fitim, me përjashtim të treve prej tyre.

Kjo është një bazë e mirë për përmirësimin e aktivitetit bankar në vitet e ardhshme.

Tabela 7: Ritmi i rritjes së zërave kryesorë të bilancit (në %).

Zërat	Ritmi
Aktivët	
Investimet në letrat me vlerë	137.7
Teprica e kredisë	20.3
Llogaritë dhe depozitat ndërbankare	7.5
Bono thesari (vlera aktuale e bonos)	2.4
Pasivët	
Llogaritë dhe depozitat ndërbankare	102.2
Burimet e përhershme	28.5
<i>Nga këto:</i> Kapitali aksioner	59.6
Llogaritë dhe depozitat e klientëve	5.5

Si pasojë e realizimit të fitimeve është përmirësuar edhe pozicioni i kapitalit në sistemin bankar. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit është 14.7 për qind nga 12 për qind që është niveli minimal i miratuar nga Banka e Shqipërisë. Pra, sistemi bankar shqiptar paraqitet i kapitalizuar. Në këtë element ka ndihmuar dhe vendimi i marrë nga Banka e Shqipërisë për të rritur kapitalin minimal të bankave në dy faza:

- faza e parë 30.09.2000 ku kapitali duhej të rritej deri në 500 milionë lekë;
- faza e dytë, që përfundon më 31.03.2001, ku kapitali minimal duhet të arrijë në 700 milionë lekë.

Afati për rritjen e parë u plotësua nga të gjitha bankat, ndërsa afati për rritjen e dytë pothuajse është plotësuar me përjashtim të tre bankave. Megjithatë, theks i veçantë duhet vënë në kapitalizimin e Bankës së Kursimeve. Në bazë të ligjit në fuqi "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" banka duhet të kapitalizohet me 17.2 miliardë lekë brenda muajit dhjetor 2000. Me këtë kapital banka e arrin dhe e tejkalon normën prej 12 për qind. Deri më sot, pronari ka përgatitur kuadrin ligjor për mbulimin e humbjeve të akumuluar, duke emetuar bono thesari për këtë vlerë.

Së fundi, duhet theksuar që aktiviteti kreditues, megjithë zgjerimin që ka patur gjatë këtij viti dhe pritshmërinë për zgjerim në vitin e ardhshëm, përsëri do të mbetet disi i kufizuar, si pasojë e nivelit të konsiderueshëm të huave me probleme. Sistemi bankar dhe, në veçanti, bankat shtetërore janë ballafaquar me probleme në drejtim të arkëtimit të kredive. Bankat shtetërore kanë një nivel shumë të lartë të huave me probleme, me rreth 89.6 për qind të portofolit, madje ato konsiderohen pothuajse të humbura.



Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të zbatojë vendimin e saj për të mos u lejuar atyre dhënien e kredive të reja. Ndërsa bankat private i kanë kreditë me probleme në masën 10.8 për qind. Kjo ka bërë që shpenzimet e sistemit bankar për të krijuar fondet rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë të rriten me 454 milionë lekë ose 7.6 për qind e të ardhurave neto nga interesat.

4.2. Privatizimi i Bankës së Kursimeve.

Procesi i përgatitjes për privatizimin e Bankës së Kursimeve ka nisur prej vitesh. Banka e Shqipërisë duke u bazuar dhe në përvojën e privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, vazhdimisht ka këmbëngulur për përshpejtimin e procesit të privatizimit, përcaktimin e afateve dhe respektimin rigoroz të tyre.

Megjithatë, në mënyrë të vazhdueshme edhe afatet e vendosura për privatizimin e Bankës së Kursimeve janë shtyrë. Aktualisht, është nënshkruar një kontratë qeverisjeje deri në privatizim e Bankës me Bankën Holandeze. Ndërsa Ministri i Financave ka ngritur grupin e punës për ndjekjen e procesit të privatizimit.

Ministria e Financave së fundi ka përgatitur projektligjin “Për mbulimin e detyrimeve të shtetit kundrejt Bankës së Kursimeve sh.a. me bono thesari”, me anë të të cilit merr përsipër mbulimin e detyrimeve të shtetit dhe humbjes së akumuluar gjatë viteve. Ndërsa deri më 31.12.2000, aksioneri i Bankës së Kursimeve sh.a. duhet të realizojë plotësimin e kapitalit, në zbatim të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.128, datë 22.12.1999. Realizimi i këtyre hapave mendojmë se krijon kushtet bazë të nevojshme për privatizimin e Bankës së Kursimeve.

4.3. Përse Banka e Shqipërisë del me deklaratë për kërcënimet mbi sistemin financiar?

Banka e Shqipërisë, pas hyrjes në fuqi të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, çdo gjashtë muaj informon në Kuvend, në Këshillin e Ministrave, dhe publikun me anë të një deklaratë që shpjegon:

- * nëse ekzistojnë kërcënime mbi stabilitetin e sistemit financiar;
- * natyrën dhe llojin e kërcënimit, duke përfshirë rishfaqjen e operacioneve të tipit të skemave piramidale;
- * nëse kërkohen si domosdoshmëri përmirësimet ligjore dhe nënligjore

në fuqi ose ndonjë iniciativë tjetër ligjvënëse.

Banka e Shqipërisë, që në janar të vitit 1998 dhe në vazhdim, çdo gjashtë muaj ka dalë me një deklaratë të kësaj natyre. Hartimi i një deklaratë të tillë u pa e nevojshme pas krizës që kaloi vendi ynë si pasojë e dështimit të skemave piramidale, si një detyrim i bashkëveprimit të instuticioneve të tilla si Banka e Shqipërisë me Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin. Gjithashtu, komunikimi në publik i një rreziku në potencë, e paralajmëron atë dhe synon rritjen e kulturës ekonomike dhe të investimit.

Banka e Shqipërisë duke qenë afër tregut bankar dhe duke parë nivelet e zhvillimit të tij, njeh, gjithashtu, edhe problemet e sistemit bankar. Niveli i kredidhënies në banka është akoma i ulët, problem i cili është ngritur vazhdimisht nga Banka e Shqipërisë. Një situatë e tillë e bën të vështirë sigurimin e një kredie nëpërmjet bankave nga ana e publikut duke përfshirë edhe biznesin, ndaj dhe ekziston rreziku i zgjerimit të tregut joformal të kredidhënies. Ky treg, për të siguruar burime, mund t'i drejtohet përsëri publikut për grumbullimin e parave. Kjo mund të çojë në një ringjallje të skemave piramidale, por tani mbase me forma dhe emra të tjerë. Popullsia, në përgjithësi, e shikon të vështirë deri në të pamundur zgjidhjen e problemit të strehimit me ndihmën e kredive bankare dhe kërkon ndonjë zgjidhje tjetër. Kështu, krijohet një fondacion ose subjekt me emër tjetër, që përcakton një kuotë anëtarësie dhe pas një periudhe jep kredi për shtëpi pa interes etj.. Raste të tilla janë shfaqur dhe janë zhdukur pa krijuar probleme pasi publiku tani është më i kujdesshëm për depozitimin e parave.

Banka e Shqipërisë si një institucion i specializuar në vlerësimin e rrezikut, që harton politikën monetare dhe që organizon vazhdimisht vrojtme të tregut bankar dhe financiar, është më afër problemeve të popullatës, dhe është në gjendje t'i njohë dhe t'i vlerësojë më mirë ato.

Kështu, ajo është në gjendje të japë alarmin në rastin e shfaqjeve të dukurive, që kanë rrezik për popullatën si dhe të paraqesë ose të kërkojë ndryshimet e nevojshme ligjore nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave.



5. ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE DHE NË TREGUN E KAPITALEVE

Në parantezë dua të theksoj që Banka e Shqipërisë është një institucion që njih dhe deklaron jo vetëm arritjet, por edhe mungesën e zhvillimeve në fusha të caktuara të aktivitetit të saj. Më konkretisht, po ndalem në sistemin e pagesave dhe në tregun e kapitaleve, zhvillimi i të cilëve nuk ka qenë i kënaqshëm gjatë vitit 2000. Megjithëse, këto dy fusha varen në masë të ndjeshme edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, pra jo ekskluzivisht nga Banka e Shqipërisë, përsëri nuk mund të deklarojmë se përpjekjet tona kanë qenë të suksesshme.

5.1. Sistemi i pagesave.

Gjatë vitit 2000 përpjekjet për përmirësimin e sistemit të pagesave mbetën ende në kuadrin e hartimit apo të miratimit të rregullave, nxjerrjes së urdhrave apo nënshkrimit të marrëveshjeve.

- U realizuan marrëveshjet për njohjen dhe përdorimin e “urdhrit për debitimin direkt” dhe “urdhrit për pagesë periodike”. Këto synojnë në nxitjen e bankave për futjen në përdorim të instrumenteve të reja të pagesës. Megjithatë, bankat që i përdorin janë të pakta.
- U hartua projektregullorja për pagesat dhe tregtinë elektronike duke u bazuar në rekomandimet e BE në këtë fushë.
- U arrit një marrëveshje e përbashkët midis bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë për unifikimin e afateve të përpunimit në sistemin bankar të urdhërpagesave dhe të çeqeve.
- U hodh një hap më tej drejt afrimit me standardet ndërkombëtare nëpërmjet standardizimit të instrumenteve të pagesës në përdorim. Kjo u mundësua si pasojë e zbatimit, gjatë vitit 2000, të marrëveshjes “Për unifikimin e urdhërpagesave dhe çekut”.

Megjithatë, mbetemi ende larg nga objektivi për përmirësimin e sistemit ndërbankar të pagesave. Kjo gjë është menduar të realizohet nëpërmjet zbatimit të sistemit të tipit RTGS. Për vënien në funksionim të këtij projekti është përcaktuar një afat kohor prej tre vjetësh. Ky angazhim është marrë dhe në kuadër të bisedimeve për asocimin në Bashkimin Europian.

5.2. Bursa.

Aktiviteti operacional i Departamentit të Bursës së Tiranës ka qenë inekzistent. Praktikisht, gjatë vitit 2000 në sesionet e Bursës së Tiranës

nuk është ekzekutuar asnjë transaksion në letrat me vlerë.

Dominimi i tregut të bonove të thesarit nga një bankë e vetme, niveli i likuiditetëve në treg dhe vendosja, për pasojë, e bankave pjesëmarrëse në Bursë, vetëm në pozicionin e blerësit bëri që të ketë mungesë transaksionesh me bonot e thesarit.

Nga ana tjetër, në Bursën e Tiranës ende nuk ka të kuotuar asnjë aksion të ndonjë shoqërie aksionere. Kjo ka ardhur kryesisht si rezultat i mospërbushjes së kriterëve cilësorë të kuotimit në bursë, të tilla si: aftësi të spikatura në menaxhim dhe prodhim raportesh financiare cilësore e transparente; moskzistencës në shumë raste të një pozite të shëndoshë financiare të ndërmarrjeve; apo mosinteresimit të këtyre të fundit për të listuar aksionet e tyre në listën zyrtare të Bursës së Tiranës dhe rrjedhimisht, i mosdëshirës së tyre për t'u kthyer në shoqëri aksionere publike e për të ngritur kapital nëpërmjet Bursës.

Megjithatë, Banka e Shqipërisë i ka vazhduar përpjekjet për të plotësuar bazën ligjore, që rregullon funksionimin dhe aktivitetin e Bursës së Tiranës si dhe ka ndërmarrë një fushatë promovimi për Bursën dhe instrumentet financiare në përgjithësi, nëpërmjet botimeve të broshurave shpjeguese, të rregulloreve apo organizimit të seminareve. Këtu do të veçoj takimin që do të organizohet brenda muajit dhjetor me temë "Ringjallja e Bursës së Tiranës", i cili do të përqendrohet në diskutimin dhe marrjen e angazhimeve nga palët përkatëse mbi mënyrën e organizimit institucional (formës së pronësisë) dhe produkteve që duhet të tregtohen në të, me synim kthimin e Bursës së Tiranës në një bursë funksionale.

6. BUXHETI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Në cilësinë e institucionit të pavarur, Banka e Shqipërisë harton dhe miraton buxhetin e saj, në Këshillin e vet Mbikëqyrës. Banka e Shqipërisë kujdeset që ky proces të zhvillohet me përgjegjshmërinë maksimale. Rregullorja në fuqi rregullon regjimin e shpenzimeve për zhvillimin normal të veprimtarisë, zbatimin e përgjegjësive për miradministrimin e fondeve dhe vendosjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

6.1. Realizimi i pritshëm për vitin 2000.

Për vitin 2000 u planifikua që të ardhurat të ishin në masën 9.9 miliardë lekë, ndërsa shpenzimet 1.1 miliardë lekë, ku shpenzimet e veprimtarisë



parashikoheshin të zinin 55 për qind të shpenzimeve gjithsej. Për pasojë, fitimi i parashikuar për t'u derdhur në buxhet ishte 8.9 miliardë lekë.

Nisur nga niveli i rezultuar i të ardhurave për periudhën janar-nëntor 2000, pritet që për këtë vit të ardhurat të tejkalohen me 1.4 miliardë lekë ose rreth 11 për qind nga parashikimi kryesisht si pasojë e rritjes së nivelit të rezervës valutore.

Përsa i takon shpenzimeve pritet që ato të realizohen në masën 95 për qind, shpenzimet e veprimtarisë në masën 93 për qind dhe janë respektuar si fondet e planifikuara për çdo artikull të buxhetit ashtu edhe për fondet e planifikuara për projekte të veçanta. Në këtë mënyrë, parashikohet që fitimi që do të derdhet në buxhetin e shtetit të jetë 10.2 miliardë lekë.

6.2. Planifikimi i buxhetit për vitin 2001.

Në vitin e ardhshëm është parashikuar që të ardhurat të rriten me 4 për qind në krahasim me realizimin e pritshëm të vitit në vazhdim, ndërsa shpenzimet do të rriten me 1.3 miliardë lekë ose 2.3 herë më shumë se realizimi i pritshëm. Për pasojë, fitimi që do të derdhet në buxhetin e shtetit do të reduktohet për 1.2 miliardë lekë.

Rritjen më të madhe në zëra parashikohet ta ketë grupi i të ardhurave të përfuara nga investimi i rezervës valutore bazuar në pritshmërinë për rritjen e hyrjeve valutore vitin e ardhshëm.

Ndërsa të ardhurat nga investimi në bono thesari do të jenë nën nivelin e pritshëm të këtij viti, bazuar në pritshmëritë për uljen e normave të interesit.

Tabela 8: Të ardhurat e Bankës së Shqipërisë (në milionë lekë).

Zërat	Viti 2000		Projektplani për vitin 2001
	Plani vjetor	Realizimi 11/mujor	
Të ardhurat nga interesat	9896.9	10347.5	11285.1
Interesa nga Qeveria	7376.9	6987.0	7075.7
Bankat e huaja dhe institucionet financiare	2516.0	3356.8	4205.6
Të tjera	4.0	3.7	3.8
Të ardhura të tjera	12.5	9.5	13.2
Të ardhura nga Shtypshkronja	62.2	57	68.2
Totali i të ardhurave	9971.6	10414.0	11366.5

Prania në publik e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

Në anën e shpenzimeve rritja më e konsiderueshme me 0.9 miliardë lekë pritet në grupin “shpenzime për remunerimin e rezervave të detyrueshme”. Vendimi i Bankës së Shqipërisë për të remuneruar rezervat do të ndikojë në përmirësimin e situatës së sistemit bankar si pasojë e uljes së kostos së ndërmjetësimit për bankat dhe do të ndihmojë Bankën e Shqipërisë në zbatimin e politikës së saj për reduktimin e normave të interesit në ekonomi.

Tabela 9: Shpenzimet e Bankës së Shqipërisë (në milionë lekë).

Zërat	Viti 2000		Projektplan për vitin 2001
	Plani vjetor	Realizimi 11/mujor	
Shpenzime për interesa	469.1	379.8	1514.3
Komisione	5.7	4.4	6.0
Shpenzime të veprimtarisë	352.1	226.4	499.9
Taksa dhe shpenzime të jashtëzakonshme	5.0	3.5	5.0
Shpenzime për amortizimin	173.2	158.8	267.9
Shpenzime për Shtypshkronjën	48.9	26.3	50.9
Totali i shpenzimeve	1054.1	799.2	2344.1

Në zërin e shpenzimeve të veprimtarisë janë planifikuar rritja e pagave me 7 për qind si dhe rritje në shërbimet e riparim-mirëmbajtjes së logjistikës e në shërbimet e tjera teknologjike. Në kuadër të rritjes së transparencës, është parashikuar rritje e konsiderueshme e shpenzimeve për botime (13 milionë lekë) si dhe është parashikuar një zë i ri, ai i shpenzimeve për organizimin e konferencave apo seminareve (8 milionë lekë).

Janë parashikuar edhe kryerja e një sërë investimeve, rreth 231 milionë lekë, si për mbulimin e kostove lokale për realizimin e programeve për zbatimin e sistemit kontabël, të sistemit RTGS si dhe të investimeve të tjera për zbatimin e tregut ndërbankar, për pajisjet informatike, për makineri për modernizimin e veprimeve të përpunimit (përfshi dhe asgjësimin) të kartëmonedhave si dhe për forcimin e masave të sigurisë për ruajtjen e parasë në venddepozitime dhe gjatë transportit të tyre. Gjithashtu, gjatë vitit 2001 do të rishtypet edhe kartëmonedha shqiptare, proces i cili pritet të kushtojë 4.5 milionë dollarë amerikanë.

Tabela 10: Zërat më kryesorë të shpenzimeve për investime (në milionë lekë).

Zërat	Shuma
Zbatimi i sistemit kontabël	84.9
Zbatimi i sistemit RTGS	28.3
Krijimi i rrjetit ndërbankar	5.6
Pajisje informatike	24.6
Makina për përpunim (përfshi asgjësimin)	38.2
Ruatja e venddepozitimeve të parave dhe transportimi	148.3
Blerje kartëmonedhe	635.8
Totali	867.5



7. INICIATIVAT LIGJORE.

7.1. Ligji “Për parandalimin e pastrimit të parave”.

Banka e Shqipërisë përfundoi inisiativën disavjeçare për hartimin dhe miratimin e ligjit nr.8610, datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”. Për momentin Banka e Shqipërisë ndjek me vëmendje procesin e zbatimit të këtij ligji nga institucionet e autorizuara si dhe vendosjen e dispozitave penale në Kodin Penal nga Ministria e Drejtësisë.

7.2. Rishikimi i ligjit nr.8089, datë 21.03.1996 “Për shoqëritë e kursim kreditit”.

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Bankën Botërore dhe organizatat e tjera joqeveritare apo qeveritare ndërkombëtare, po asiston në përmirësimin e ligjit nr. 8089, datë 21.03.1996 “Për shoqëritë e kursim-kreditit”. Qëllimi i rishikimit, i cili është në fazën e miratimeve në Këshillin e Ministrave është

- a) konsolidimi i dispozitave sipas praktikës së deritanishme;
- b) integrimi i shoqërive të kursim-kreditit në sistemin bankar.

7.3. Përgatitja e projektligjit “Për garantimin e depozitave”.

Banka e Shqipërisë ka përfunduar projektligjin për garantimin e depozitave bankare. Projektligji është diskutuar me bankat e nivelit të dytë si dhe me FMN-në. Në kushtet e kalimit të bankave nga pronësia shtetërore në pronësi private si dhe me zgjerimin e sistemit bankar me banka të reja, Banka e Shqipërisë shikon ndryshime në ambjentin në të cilin bankat kryejnë veprimtarinë e tyre. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë jo vetëm ndërmerri inisiativa për konsolidimin e mëtejshëm të këtij sistemi, por edhe e plotëson atë me struktura e mekanizma të reja të domosdoshme të tregut. Projektligji do të paraqitet në Qeveri brenda muajit dhjetor 2000.

7.4. Përgatitja e projektamendamenteve të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”.

Përgatitja e amendamenteve të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” është e kushtëzuar nga kërkesat e Kushtetutës. Meqenëse Kushtetuta e imponon reflektimin e ndryshimeve në ligjin e saj kuadër, atëherë, Banka e Shqipërisë me mbështetjen e FMN-së ka përgatitur edhe ndryshime të tjera me qëllim që të përforcojë statusin e

saj si institucion publik i pavarur. Ndryshimet nuk kanë për qëllim të ndryshojnë strukturën dhe përmbajtjen e dispozitave të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”. Këto amendamente mendohet të paraqiten brenda tremujorit të parë të vitit 2001. Ato konsistojnë në:

- Emërimin e Guvernatorit si e parashikon Kushtetuta (pra, nga Kuvendi dhe jo më nga Presidenti).
- Përfshirjen e një klauzole që sanksionon të drejtën e Bankës së Shqipërisë për të përdorur në mënyrë të pavarur instrumentet e politikës monetare për të arritur objektivat e kësaj politike. Një klauzolë e tillë përfshihet me qëllim që të forcohet pavarësia institucionale e Bankës së Shqipërisë.
- Sanksionimin e të drejtës së mbajtjes dhe administrimit të rezervës valutore të Republikës së Shqipërisë, dhe jo vetëm të Bankës së Shqipërisë, siç parashikohet në ligjin në fuqi, me idenë që të ketë një rezervë valutore dhe jo një e Bankës dhe një e Qeverisë.
- Përjashtimin nga kredia që i jepet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të letrave me vlerë të borxhit të emetuara prej saj, që blihen nga Banka e Shqipërisë në tregun sekondar.
- Plotësimin e dispozitës për statusin e nëpunësit të Bankës së Shqipërisë në raport me Kodin e Punës dhe me statusin e nëpunësit civil.
- Mundësinë e mbrojtjes së administratorëve dhe të nëpunësve të Bankës së Shqipërisë nga paditë e ngritura në funksion të ushtrimit të detyrave në përputhje me ligjin.
- Evitimin e papajtueshmërisë në funksionin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës.
- Mundësinë për të krijuar subjekte të veçanta të së drejtës dhe me personalitet të veçantë duke mundësuar shkëputjen nga strukturat e brendshme të Bankës së Shqipërisë.

8. RITJA E TRANSPARENCËS.

Në qershor të vitit 2000, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, miratoi rregulloren “Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë”. Kjo rregullore u hartua në përmbushje të kërkesave të nenit 23, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 43, gërma f të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” dhe ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” si dhe për të respektuar standardet ndërkombëtare në fushën e transparencës së bankave qendrore. Objekti i saj është “ritja e transparencës në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë si dhe administrimi i informacionit jopublik në Bankën e Shqipërisë”.



Rritja e transparencës në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë është një ndër objektivat strategjikë të saj dhe përbën një detyrim të këtij institucioni. Vetëm nëpërmjet rritjes së transparencës Kuvendi, si organi prej të cilit varet banka qendrore, por edhe Qeveria e publiku do të mund të vlerësojnë efektshmërinë e punës së Bankës së Shqipërisë dhe të vlerësojnë se sa e suksesshme ka qenë ajo.

Pra, mund t'ju themi se angazhimi për rritjen e transparencës nisët nga synimi për të rritur përgjegjshmërinë në punën e Bankës së Shqipërisë, për të rritur besimin te ky institucion, për të respektuar kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe ato të standardeve ndërkombëtare. Banka Shqipërisë e konsideron rritjen e transparencës edhe si pjesë e një tjetër detyrimi që ajo ka marrë mbi vete, edukimin e publikut me problemet ekonomike.

Aspekti më i rëndësishëm i këtij angazhimi është rritja e transparencës me Kuvendin. Si organi më i lartë legjislativ dhe prej të cilit varet drejtpërsëdrejti banka qendrore, ju keni të drejtë të dini si i respekton Banka e Shqipërisë detyrat ligjore të përcaktuara prej jush dhe sa e suksesshme ka qenë ajo në arritjen e objektivit të saj kryesor.

Rritja e transparencës me Kuvendin është menduar të realizohet nëpërmjet raportimeve më të shpeshta të Guvernatorit të Bankës në Komisionin për Ekonominë, Financën dhe Buxhetin apo në seanca plenare, nëpërmjet publikimeve që dërgojmë rregullisht, por edhe nëpërmjet organizimit të seminareve e konferencave nga Banka, ku janë ftuar deputetët e në veçanti anëtarët e këtij komisioni. Duke raportuar në mënyrë të vazhdueshme dhe me seriozitet për punën tonë, do të sigurojmë një bashkëpunim më të ngushtë të të dyja palëve dhe një reagim pozitiv ndaj përpjekjeve të Bankës së Shqipërisë për të forcuar pavarësinë reale të saj, pasi në këtë mënyrë kemi vërtetuar se nuk kemi abuzuar me pushtetin e dhënë me ligj. Ky reagim besoj se do të pasqyrohet në diskutimin e projektligjit "Për Bankën e Shqipërisë".